



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 69 datë 28.10. 2022



“Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 1.211 ha “Për Mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme” në ekonomine pyjore Gomsiqe .

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, neni 18 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 57/2020, date 30.4.2020 “Për Pyjet”, neni 25, **pika 49** e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënje në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” **me shumicë të cilësuar votash.**

V E N D O S I

1. Miratimin e dhënies në përdorim(qira) të sipërfaqes prej **1.211 ha “Për Mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme” në ekonomine pyjore Gomsiqe dhe** që bën pjesë në **ngastrat nr.16;17** të ekonominë pyjore **Gomsiqe**, sipas listës së inventarit,**shtojca nr.47** dhe janë në pronësi/administrim të Bashkisë Vau Dejës.
2. Afati i dhënies me qera të jetë 10 (dhjetë) vjet me të drejtë rinovimi.
3. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM-së **nr.559, datë 29.07.2022** “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”,Shtojca 1,pika 3/1;2
4. Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti , sigurohen të ardhura të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
5. Ngarkohen Drejtoria e pyjeve,Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

K R Y E T A R
Mark Bisha

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Ardian Çelepija

Miratuar me 21 vota

Vota Pro 21

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 02.11 2022





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER



Nr. 738/2 Prot.

Shkodër, më 16.11.2022

Lënda: Mbi Vendimin nr. 69, datë 28.10.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja “a”, neni 18, neni 27, pika 5, neni 54, shkronja “e/1”, neni 55, pika 3, neni 64, shkronja “c”, të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, neni 25, pika 1, shkronja “b”, të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike, sipas listave te inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar, pika 49, shtojca 47, VKM nr. 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” shtojca 1, pika 3/1 & 3/2, të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, shkreses së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 6175 prot., datë 02.11.2022 “Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, të datës 28.10.2022”, shqyrtoi *VKB nr. 69, datë 28.10.2022 “Për dhënie në përdorim me afat 10 vjeçar të sipërfaqes pyjore prej 1.211 ha, në ngastrat nr. 16 dhe 17, në ekonominë pyjore Gomsiqe, për mbarështimin e florës dhe faunës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme”.*

Pas shqyrtimit, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm. Në vëmendjen Tuaj se e drejta e rinovimit është kompetencë e Kryetarit të Bashkisë në zbatim të nenit 64, shkronja “gj¹” e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T

Majlinda ANGONI



¹ Nëse sipas monitorimit të kontratës subjekti ka përmbushur detyrimet kontraktuale.